

BOTIMI I TRETË

Belbëzimi: të bisedojmë singerisht me mësimdhënësit



Doracak për mësimdhënëës dhe logopedë

8 këshilla për mësuesin

1. Mos i thuaj fëmijut "më ngadalë" ose "vetëm relaksohu".

2. Mos i'a plotëso fjalinë fëmijut ose mos fol në vend të tij.



3. Ndhimjoju të gjithëve në klasë që të mësohen të flasin dhe të dëgjojnë me rradhë. Te gjithë fëmijët - veçanërisht ata që belbëzojnë - e kanë më të lehtë të flasin kur kanë më pak ndërprerje dhe e kanë vëmendjen e dëgjuesve.

4. Prisni kualitet dhe kuantitet të njëjtë të punës, si prej nxënësve që belbëzojnë si prej atyre që nuk belbëzojnë.

5. Flisni me nxënësit pa nxitim, duke paizuar shpesh.

6. Le të kuptohet se ju jeni duke e dëgjuar përmbajtjen e mesazhit, e jo mënyrën si është thënë.

7. Bisedo sy me sy me nxënësin që belbëzon për nevojat e tij në klasë që të ndihet sa më komod. Respekto nevojat e nxënësit, por vetëm nëse ato janë të mundura.

8. Mos e bëni belbëzimi diçka që duhet të të vijë turp.

Flisni për belbëzimin si për çdo gjë tjetër.



Hartuar nga Lisa Scott, Ph.D. , Universiteti Shtetëror – Florida

Copyright © 2010 nga Stuttering Foundation of America®. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

800-992-9392/www.stutteringhelp.org

Është prodhuar dhe shkruar nga Lisa Scott, Ph.D., Universiteti Shtetëror Florida, dhe Carroll Guitar, M.L.S., Universiteti Vermont; në bashkëpunim me Kristin Chmela, M.A., Universiteti Northwestern; Jane Fraser, President, Stuttering Foundation; dhe Bill Murphy, M.A., Universiteti Purdue. Në bashkëpunim me Joseph Donaher, Ph.D., Spitali i Fëmijëve në Filadelfi dhe Lee Caggiano, M.A., klinikë private.

Belbëzimi: të bisedojmë sinqerisht me mësimdhënësit

Doracak për mësimdhënësit dhe logopedë

Botimi i tretë - 2010

Përktheu nga origjinali:

Shkurte Berisha

Botuar nga:

Shoqata Kosovare për Belbëzim

The Stuttering Foundation

Post Office Box 11749

Memphis, TN 38111-0749

Copyright © 2002-2010 nga Stuttering Foundation of America®

The Stuttering Foundation është një organizatë bemirëse jo fitimprurëse e dedikuar për parandalimin dhe tretmanin e përmirësuar për belbëzim. Kontribuesit janë me tatim të zbritur.

ISBN 978-9951-698-01-6

Katalogimi në botim - (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

616.89-008.434-053.2/.3(036)

615.851.135-053.2/.3(036)

Belbëzimi: të bisedojmë sinqerisht me mësimdhënësit: doracak për mësimdhënësit dhe logoped / hartuar nga Lisa Scott ; përktheu nga origjinali Shkurte Berisha. - Botimi i tretë. - Prishtinë : Shoqata Kosovare për Belbëzim, 2014. - 35 f. : ilustr. me ngjyra ; 21 cm.

1. Scott, Lisa 2. Berisha, Shkurte

ISBN 978-9951-698-01-6

PJESA I

Për mësimdhënësit*

Belbëzimi është një çrregullim në komunikim, që ndërhyt në aftësinë e personit për të folur rrjedhshëm. Ai përfshin përsëritjen, zgjatjen, ose bllokimin e tingujve, rrokjeve ose fjalëve.

Kur një fëmijë belbëzon, mund të ndikohet performanca e tij akademike dhe jeta e tij shoqërore: ai mund të hezitot të ngris dorën në klasë, të lexojë me zë, ose të bisedoj me fëmijët tjerë në klasë. Ky doracak është disenjuar për t'ju dhënë informata praktike lidhur me belbëzimin dhe për t'ju sugjeruar strategjitë që mund t'ju ndihmojnë për të plotësuar sa më mirë nevojat e fëmijëve në klasën tuaj. Këtu mund të gjeni:

1. Informata të përgjithshme lidhur me belbëzimin;
2. Një listë të plotë për ta referuar rastin te një logoped nëse jeni të shqetësuar se një nxënës në klasën tuaj mund të jetë duke belbëzuar;
3. Përgjigjet për pyetjet që mund t'i keni lidhur me belbëzimin;
4. Një pamje e përgjithshme se çfarë ndodh në terapinë e të folurit;
5. Sugjerime lidhur me informatat që mund t'i ndani me logopedin;
6. Sugjerime lidhur me informatat që mund t'i ndani me prindërit;
7. Një përshkrim të shkurtë të burimeve të ndryshme lidhur me belbëzimin, ngacmimin, dhe ndërtimin e vetë-besimit te fëmijët. Disa nga këto burime janë të përshtatura për mësimdhënës, disa për fëmijë, dhe të tjerat për prindër. Një sqarim i shkurtë i secilit burim është shoqëruar së bashku me listën.

Informata të përgjithshme lidhur me belbëzimin

Kjo pjesë ka të bëjë me informatat e përgjithshme lidhur me belbëzimin, duke përfshirë shkaktarët e belbëzimit, fakte lidhur me belbëzimin, si duket belbëzimi, dhe si mund të ndihen fëmijët lidhur me belbëzimin.

Shkaktarët

- Belbëzimi zakonisht fillon mes moshës dy dhe katër vjet. Derisa shkaktarët e belbëzimit nuk janë të njohur, hulumtuesit e kësaj lëmie pajtohen se belbëzimi është e mundur që rezulton nga një ndërveprim i faktorëve përfshirë zhvillimin e fëmijut, dinamikën e familjes, gjenetikën dhe neuropsikologjinë.

* Në këtë doracak me termin mësimdhënës përfshihen mësuesit e nivelit të ulët në shkollë fillore, arsimtarët e nivelit të lartë në shkollë fillore dhe profesorët në shkollë të mesme.

Fakte lidhur me belbëzimin

- Ka më shumë djem se vajza që belbëzojnë. Në moshën 2 vjeqare, ky raport është përafërsisht dy djem për secilën vajzë, por në moshën 5 vjeqare, ky raport është përafërsisht katër djem për secilën vajzë.
- Përafërsisht 5 përqind e të gjithë fëmijëve kalojnë nëpër një periudhë të belbëzimit që zgjat gjashtë muaj apo më shumë. Tri të katërtat e tyre do të shërohen deri në fëmijërinë e vonshme, duke mbetur 1% me një problem afatgjatë.
- Nëse një fëmijë ka belbëzuar më shumë se tri vjet, megjithatë, është shumë e vështirë që ai ta tejkaloj atë problem. Për shkak se shumica e fëmijëve fillojnë të belbëzojnë gjatë viteve të tyre parashkollore, një fëmijë që belbëzon në shkollë fillore ose të mesme, është shumë vështirë të tejkaloj këtë problem.
- Nuk ka ndonjë shërim të njohur për belbëzim, përfshirë edhe terapitë e të folurit. Në vend të kësaj, terapitë e të folurit ju ndihmojnë fëmijëve për të mësuar të flasin në një mënyrë më të lehtë, madje edhe mjaft rrjedhshëm, dhe që të kenë qëndrime dhe ndjenja të shëndosha lidhur me të folurit.
- Belbëzimi nuk është shkaktuar nga dallimet psikologjike. Fëmijët nuk fillojnë të belbëzojnë për shkak se janë më ansioz, më të turpshëm, ose më depresiv se fëmijët tjerë.
- Fëmijët që belbëzojnë nuk tregojnë ndonjë dallim në inteligjencë nga fëmijët tjerë që nuk belbëzojnë.
- Sasia e belbëzimit që dëgjoher në të folurit e fëmiut dallon sipas situatave folëse dhe sipas bashkëbiseduesit. Për shembull, një fëmijë mund të mos belbëzoj fare kur flet me një shok, por do të belbëzoj më shumë kur lexon me zë në klasë.
- Belbëzimi mund të jetë me cikle, do të thotë herë vjen dhe herë shkon. Frekuenca dhe intensiteti i belbëzimit të një fëmiu mund të ndryshoj dramatikisht përgjatë periudhës së disa javëve ose muajve.
- Fëmijët që belbëzojnë mund të jenë të vetëdijshëm lidhur me belbëzimin e tyre dhe zgjedhin që mos të marrin pjesë në biseda në klasë.
- Shumë njerëz të famshëm dhe të suksesshëm kanë belbëzuar. Këtu përfshihen James Earl Jones, John Stossel, Kenyon Martin, Darren Sproles, Annie Glenn, Bill Walton, Mel Tillis, Nicholas Brendon, Joe Biden, Carly Simon, Ken Venturi, Bob Love, John Updike, Lewis Carroll, Mbreti George VI, Winston Churchill, Marilyn Monroe dhe John Melendez. Poster i The Stuttering Foundation, 18 njerëzit e famshëm, ilustron disa nga këta njerëz të famshëm. (Një kopje me ngjyra e këtij poster mund të gjindet në faqen 16 dhe 17 të këtij doracak).

Fakte tjera lidhur me belbëzimin mund të gjinden në fletën e fakteve që mund të gjindet në **The Stuttering Foundation: A e keni ditur, një fletë me fakte lidhur me belbëzimin**, gjithashtu në këtë doracak në faqen 14.

Si duket dhe si tingëllon belbëzimi

Belbëzimi zakonisht ndodh në fillim të tingujve ose të fjalëve në një fjali, ose në kufijtë e fjalisë. Ekzistojnë tri mostra kryesore të belbëzimit. Ju mund të dëgjoni fëmiun në klasën tuaj duke belbëzuar në vetëm njërën prej këtyre mënyrave; të tjerët mund të tregojnë variacione të konsiderueshme në mostrat e belbëzimit.

1. Përsëritjet e tingujve dhe rrokjeve. Fëmiu zakonisht do të përsërit tingullin ose rrokjen tri herë ose më shumë.

M-m-m-mund të shkoj në banjo?

Unë-unë-unë-unë e di përgjigjen!

2. Zgjatjet e tingujve. Ju do të dëgjoni fëmiun “duke mbajtur” tingullin derisa provon për ta thënë atë.

Ssssskeçi ishte interesant.

Eeeeeeeedhe pse libri ishte i vështirë për të lexuar, më pëlqeu.

3. Bllokimet. Kur fëmiu është bllokuar në një tingull, ju mund ta shihni atë duke tentuar për ta thënë fjalën, por ju nuk dëgjoni asnjë tingull të del nga goja e tij. Kjo periudhë e heshtjes shpesh është e përcjellur nga një shpërthim i shpejtë i tingullit kur ai përfundimisht është i aftë për ta thënë fjalën.

Është gjithashtu e zakonshme që ta dëgjoni fëmiun duke përdorur “ëm”, ose “uh” derisa ai lufton për të vazhduar të folurin, ose ai ndryshon intensitetin ose zëshmërinë derisa provon të thotë një fjalë në të cilën belbëzon.

Përveç belbëzimit që e dëgjoni, ju mund të shihni fëmiun duke mbyllur sytë ose buzët, faqet ose nofulla bëhen shumë të tensionuara gjatë belbëzimit. Disa fëmijë madje mund t'i tundin edhe gishtat ose këmbët, ose lëvizin trupin e tyre në mënyra tjera derisa tentojnë të thonë një fjalë veqanërisht të vështirë. Këto sjellje, që quhen sjellje sekondare ose përcjellëse, zakonisht ndodhin për shkak se fëmiu është duke tentuar me forcë ta nxjerrë fjalën jashtë.

Si mund të ndjehen fëmijët lidhur me belbëzimin

Disa fëmijë që belbëzojnë nuk kanë ndonjë ndjenjë negative lidhur me të folurit e tyre, por fëmijë të tjerë mund të ndjehen të frustruar, ansioz, të sikletosur ose madje edhe të turpshëm. Është me rëndësi të dijmë se ndjenjat e fëmiut lidhur me të folurit mund të mos jetë i lidhur aspak me atë se sa shumë belbëzon. Kjo do të thotë që një fëmijë që ju e shikoni të belbëzoj shpesh dhe me intensitet të lartë mund të mos ndjehet keq aspak lidhur me të folurit e tij në klasë, derisa një fëmijë tjetër, belbëzimi i të cilit është i butë mund të ndjehet ansioz dhe i frikësuar.

Nëse fëmiu ka ndjenja negative lidhur me të folurit, ai mund të mos ketë vullnet për të ngritur dorën, duke pretenduar se ai nuk e di përgjigjen kur ta thirrni për t'u përgjigjur, ose mund të tërhiqet nga situatat sociale siq janë të ulurit afër dikujt tjetër gjatë drekës ose loja në grup në oborr.

A mund ta bëni një referim?

Ju mund ta keni porositur DVD-në apo doracakun për shkak se jeni të brengosur lidhur me një fëmijë në klasën tuaj që mund të jetë duke belbëzuar. Lista e plotë referuese e mësimdhënësit mund t'ju ndihmojë që të vendosni.

TABELA I:

Lista e plotë e mësimdhënësve për referim

	Ndoshta jorrijedhshmëri normale	Ndoshta belbëzim
Sjelljet e të folurit që mund t'i shihni ose t'i dëgjoni:	<input type="checkbox"/> Përsëritje të rastit (më pak se një në çdo 10 fjali), të shkurta (më pak se 1/2 sekonda) të tingujve, rrokjeve, ose fjalëve të shkurta si-sikurse kjo. Tingujt, rrokjet ose fjalët përsëriten vetëm njëherë ose dyherë, për shembull alo-alo, shu-shu-shumë.	<input type="checkbox"/> Përsëritje të shpeshta (3 ose më shumë në çdo 10 fjali), të gjata (më shumë se 1/2 sekonda) të tingujve, rrokjeve ose fjalëve të shkurta, si-si-si-sikurse kjo. Tingujt, rrokjet dhe fjalët e shkurta zakonisht përsëriten 3 ose më shumë herë, p-p-p-p-për she-she-she-shembull. Zgjatje të rastit të tingujve sssssikurse kjo, ose bllokimet.
Sjellje të tjera që mund t'i shihni ose dëgjoni:	<input type="checkbox"/> Pauza dhe hezitime të rastit gjatë të folurit, ose plotësues si "uh", "ër" ose "ëm", që vërehen zakonisht kur fëmiju është duke i ndryshuar fjalët ose mendimet.	<input type="checkbox"/> Përsëritjet ose zgjatjet mund të jenë të shoqëruara me mbyllje ose pultitje të syve, largim të shikimit, dhe tensionim të disa muskujve në dhe rreth gojës. Mund të dëgjojen edhe ndryshime në lartësi ose zëshmëri derisa fëmiju lufton për të thënë fjalën. Fëmiju mund të thotë tinguj ose fjalë shtesë si fillues, p.sh. "Mirë në rregull m-m-m-mua më nevojiten ngjyrat".
Kur është më i vërejtur problemi:	<input type="checkbox"/> Ka tendencë që kjo të vjen dhe shkon kur fëmiju është: i lodhur, i eksituar, flet për tema të reja dhe më komplekse, pyet ose përgjigjet në pyetje, ose flet me një dëgjues që nuk reagon.	<input type="checkbox"/> Mund të vjen dhe shkon në situata të ngjashme, por është më shumë prezent se sa mungon. Nëse vërehet në shumicën e situatave folëse dhe është i vazhdueshëm, problemi mund të jetë i madh.
Reaksionet e fëmijut:	<input type="checkbox"/> Nuk vërehet.	<input type="checkbox"/> Mund të shfaq brengosje, sikletosje, frustrim, frikë ndaj të folurit. Mund të jetë ngurrues për të marrë pjesë në aktivitetet e klasës si leximi me zë, ose ngritja e dorës gjatë periudhës së pyetjeve-përgjigjeve.
Reaksionet e bashkëmohatarëve:	<input type="checkbox"/> Nuk vërehet.	<input type="checkbox"/> Mund të shfaq brengosje, sikletosje, frustrim, frikë ndaj të folurit. Mund të jetë ngurrues për të marrë pjesë në aktivitetet e klasës si leximi me zë, ose ngritja e dorës gjatë periudhës së pyetjeve-përgjigjeve.
Reaksionet e prindërve:	<input type="checkbox"/> Jo në masë të madhe	<input type="checkbox"/> Një shkallë e caktuar e brengosjes
Vendimi për referim të rastit	<input type="checkbox"/> Nuk ka nevojë për referim	<input type="checkbox"/> Referoni për kontroll



Gjitashtu flisni me prindërit e fëmijut për të kuptuar a janë edhe ata të brengosur, dhe a ka qenë fëmiju ndonjëherë në vlerësim të të folurit ose në ndonjë terapi për të folurit.

Pyetjet që mund të dëshironi t'i pyesni prindërit përfshijnë:

1. A e keni vërejtur që fëmiju juaj përsërit një pjesë të fjalës sesa komplet fjalën ose frazën? (për shembull, “a-a-a-anija”)
2. A e keni dëgjuar fëmijun tuaj të përsërit tinguj më shumë se një herë në çdo 8 ose 10 fjali?
3. Kur e dëgjoni fëmijun tuaj të përsëris, a dëgjoni më shumë se dy përsëritje? (për shembull, “a-a-a-a-anija” në vend se “a-a-anija”).
4. A duket fëmiju juaj i frustruar ose i sikletosur kur ka vështirësi në ndonjë fjalë?
5. A ka folur fëmiju juaj në këtë mënyrë më shumë se një vit?
6. A e keni vërejtur ndonjëherë fëmijun tuaj të ngris lartësinë e zërit, të mbyll sytë, të largoj shikimin, ose të ketë tension të muskujve në fytyrë kur belbëzon?
7. A përdor fjalë shtesë si “uh” ose “ëm” ose “mirë” për të filluar një fjalë?
8. A bllokohet aq shumë fëmiju juaj ashtu që asnjë tingull nuk i del jashtë?
9. A e keni vërejtur ndonjëherë fëmijun tuaj të përdor lëvizje shtesë të trupit, si lëkundja e gishtit, për të nxjerrë një tingull jashtë?
10. A mendoni se fëmiju juaj ndonjëherë i shmanget të folurit, zëvendëson fjalët, ose e ndalon të folurit në mes të fjalisë për shkak se ai mund të belbëzoj?

Këto pyetje janë të listuara sipas seriozitetit të problemit. Nëse prindi përgjigjet me “po” në cilëndo pyetje më shumë se 1 herë, kjo sugjeron mundësinë e belbëzimit sesa të një jorrijedhshmërie normale. Së bashku me prindin, ju mund të vendosni a të bëni një referim për te logopedi.

Pyetjet që kanë shpesh mësimdhënësit lidhur me belbëzimin

Çfarë të bëj kur një fëmijë belbëzon në klasën time?

Gjëja më e rëndësishme për të bërë, kur një fëmijë është duke belbëzuar, është të jeni ju vetë një komunikues i mirë.

- Mbani kontaktin me sy dhe i jepni fëmiut kohë të mjaftueshme për të përfunduar të folurit.
- Tentoni që mos t'ia plotësoni fjalët ose fjalitë.
- Le ta kuptoj fëmiju nga mënyra dhe veprimet e juaja se ju jeni duke e dëgjuar se çfarë po thotë – dhe jo mënyrën si po e thotë atë.
- Modeloni një kohë pritëse – prisni dy sekonda para se t'i përgjigjeni pyetjes së fëmiut – dhe përdorni më shumë pauza në të folurin tuaj për t'i ndihmuar për të redukuar presionin e të folurit.

Këto sugjerime janë të dobishme **për të gjithë** fëmijët në klasën tuaj.

Mos bëni vërejtje si “më ngadalë”, “merrni shumë frymë”, “relaksohuni”, ose “mendoni lidhur me atë se çfarë dëshironi të flisni, e mandej thuani atë”. Ne shpesh i'u themi këto gjëra fëmijëve për shkak se të ngadalësuarit, relaksimi, ose mendimi lidhur me atë që do të themi na ndihmon neve kur ndihemi sikur kemi problem të kalojmë nëpër fjalët tona. Megjithatë, belbëzimi është një lloj tjetër i problemit të të folurit; dhe këshillat e tilla janë thjesht të padobishme për fëmijun që belbëzon.

A duhet t'ia përkujtoj fëmiut të përdor në klasë teknikat e terapisë së tij për belbëzim?

Përveç kur fëmiju ose logopedi ju kërkojnë në mënyrë specifike për t'i ndihmuar që t'ia rikujtoni ato, më mirë është që këtë mos ta bëni.

Gjatë terapisë, fëmiju që belbëzon mëson disa teknika të ndryshme, që nganjëherë quhen mjete të të folurit, për të menaxhuar belbëzimin e tij. Megjithatë, të mësuarit për t'i përdorur këto mjete të të folurit në situata të ndryshme (p.sh. në klasë krahasuar me dhomën e terapisë) marrin kohë dhe praktikë të konsiderueshme. Shumë fëmijë të vegjël që belbëzojnë nuk e kanë pjekurinë për të monitoruar të folurit e tyre në të gjitha situatat. Prandaj, është jorealiste të pritet që fëmiju të përdor mjetet e tij edhe në klasë.

Çfarë duhet të bëj kur fëmiu ka një ditë të vështirë në të folur?

Është gjithnjë më mirë të vërtetoheni me fëmiun lidhur me atë se çfarë dëshiron ai që ju të bëni në ditët kur të folurit është më i vështirë për të.

Fëmijët që belbëzojnë ndryshojnë shumë në atë se si ata dëshirojnë që mësimitdhënësit dhe bashkëmoshatarët të reagojnë kur ata kanë një kohë posaqërisht të vështirë në të folur. Një fëmijë mund të preferoj që mësimitdhënësi i tij ta trajtoj në mënyrë të njëjtë siq e trajton mësimitdhënësi çdo ditë tjetër, duke e thirrur atë në mënyrë spontane dhe duke kërkuar nga ai që të lexoj me zë.

Nga ana tjetër, një fëmijë tjetër mund të dëshiroj që mësimitdhënësi i tij përkohësisht të reduktoj pritjet e tij për pjesëmarrjen verbale të tij, duke e thirrur atë vetëm kur ai të ngris dorën ose duke i lejuar atë të kaloj rradhën gjatë aktiviteteve si leximi me rradhë.

Çfarë duhet të bëj kur një fëmijë që belbëzon i ndërhyt në fjalë një fëmiu tjetër?

Trajtoni ndërhyrjet në mënyrë të njëjtë si do t'i trajtonit për një fëmijë që nuk belbëzon. Fëmijët që belbëzojnë nganjëherë i ndërhyjnë të tjerëve për shkak se e kanë më të lehtë për të filluar të folurit derisa flet dikush tjetër. Ne nuk jemi të sigurt saktësisht pse është më lehtë të flitet derisa flet dikush tjetër, por kjo mund të jetë për shkak të vëmendjes më të vogël që drejtohet nga fëmiu në fillim të rradhës së tij kur belbëzimi ka më shumë gjasa të ndodh.

Edhe pse është më lehtë për të filluar të folurit duke ndërhyrë kur flet një bashkëmoshatar, është me rëndësi për fëmiun që belbëzon që të mësohet me rregullat për një komunikim të mirë si të gjithë fëmijët tjerë në klasën tuaj.

Si mund t'i bëj raportet me gojë më të lehta për një fëmijë që belbëzon?

Ka shumë gjëra që mund të bëni për të ndihmuar që një raport me gojë të bëhet përvojë pozitive për një fëmijë që belbëzon. Së bashku, ju dhe fëmiu mund të zhvillonin një plan, duke i marr parasysh faktorët si:

- Rradha – a dëshiron ai të jetë njëri nga të parët gjatë prezentimeve, në mes, apo njëri nga të fundit gjatë prezentimeve.
- Mundësitë e praktikimit – mënyrat që ai mund të praktikoj atë që do t'i ndihmojnë që të ndjehet më rahat, si në shtëpi, me ju, me një shok, ose gjatë sesioneve të terapisë për të folur;
- Madhësia e audiencës – a dëshiron të raportoj me gojë vetëm para juve, në një grup të vogël, ose para tërë klasës; dhe
- Qështje tjera – a duhet të kufizohet në kohë, ose a duhet të modifikohet kriteri i kohës për shkak të belbëzimit.

A duhet të flas para tërë klasës lidhur me belbëzimin?

Ju duhet ta diskutoni këtë ide me fëmijun dhe duke u konsultuar me logopedin e fëmijut. Disa fëmijë nuk e kanë problem nëse flisni me bashkëmoshatarët e tij lidhur me belbëzimin. Megjithatë të tjerët, e ndjejnë se belbëzimi është një qështje private që nuk duhet të diskutohet hapur me fëmijët tjerë në klasë.

Nganjëherë, një fëmijë që belbëzon mund ta bëjë një prezentim para klasës lidhur me belbëzimin. Ky prezentim i mundëson fëmijut që t'i mësojë bashkëmoshatarët e tij fakte lidhur me belbëzimin, t'i informojë për emrat e njerëzve të famshëm që kanë belbëzuar, të ofrojë sugjerime lidhur me atë si dëshiron ai që të reagojnë bashkëmoshatarët e tij kur ai belbëzon, dhe madje t'i mësojë të tjerët lidhur me mënyrat e ndryshme të belbëzimit.

Njëra prej përfitimeve që i kemi vërejtur nga prezentimi para klasës i fëmijëve që belbëzojnë lidhur me belbëzimin është reduktimi i ngacmimeve. Nëse fëmijët tjerë kuptojnë më shumë lidhur me problemin, ka më pak mundësi që ata të tallin ose ngacmojnë fëmijun që belbëzon.

Ky nuk është një aktivitet i qëlluar për të gjithë fëmijët që belbëzojnë, pasi disa nuk janë ende të gatshëm të ballafaqohen me belbëzimin në mënyrë kaq të hapur. Prezentimi para klasës lidhur me belbëzimin është një komponentë e terapisë për belbëzim, që zakonisht bëhet së bashku me vizitën e logopedit në klasë. Nëse ju keni dilemë a duhet të bëjë fëmiju një prezentim para klasës, konsultohuni me logopedin.

Nëse fëmiju në klasën tuaj do të bëjë një prezentim lidhur me belbëzimin, The Stuttering Foundation ka një "paketë për prezentim para klasës" me broshura, informata dhe poster që mund t'i përdorni ju dhe fëmiju gjatë prezentimit.

Si mund ta trajtoj ngacmimin?

Përballuni me ngacmimin ndaj fëmijut që belbëzon krejt njësoj si do të përballeni me ngacmimet ndaj fëmijëve tjerë. Për fat të keq, ngacmimi është një përvojë e përbashkët te shumë fëmijë.

Siq është cekur më herët, prezentimi para klasës mund të jetë një mënyrë e fuqishme për të reduktuar ngacmimet nëse fëmiju që belbëzon është i gatshëm për të bërë një prezentim të tillë.

Në të kundërtën, ngacmimet mund të ndalen vetëm me intervenimin tuaj. Shumë shkolla kanë rregulla të shkruara si të menaxhohen ngacmimet në klasë, dhe këshilltari i shkollës ose punëtori social janë një burim i shkëlqyer i informacionit.

Një libër me sugjerime humoristike dhe praktike për ngacmimin është "Bullies Are a Pain in the Brain (Ngacmimet janë dhimbje për trurin)" me autor Trevor Romain nga Free Spirit Publication. Burime tjera për fëmijë, mësimdhënës dhe prindër mund të gjinden në fund të këtij doracak.

Këtu janë disa sugjerime tjera:

1. Dëgjoje fëmiun dhe jepi menjëherë mbështetje. Mos e tejkalo ngacmimin me vërejtjen si "këtë e bën çdokush".
2. Diskutoni zgjidhjen e problemit dhe strategjitë e ballafaqimit me ngacmimet së bashku me fëmiun dhe zgjidhni disa që i përshtaten atij ose asaj. Këto zgjidhje të problemit dhe strategji të ballafaqimit mund të jenë pjesë edhe e terapisë për belbëzim.
3. Edukoni të tjerët. Sa më shumë që të tjerët kanë njohuri lidhur me belbëzimin, më pak gjasa ka që të ngacmojnë.
4. Bisedoni me klasën lidhur me ngacmimet në përgjithësi. Fëmiu që belbëzon ndoshta nuk është i vetmi që ngacmohet.
5. Bisedoni me prindër, logopedin dhe mësimdhënësit tjerë që të jeni të një mendimi.

Çfarë mund t'i them një fëmiu që belbëzon për t'i dhënë kurajo të flas në klasë?

Mënyra më e mirë për t'i dhënë kurajo një fëmiu që belbëzon për të folur në klasë është që ai të kuptoj përmes fjalëve dhe veprimeve tuaja se ajo çfarë ai thotë është e rëndësishme, e jo mënyra si e thotë atë. Mënyra tjera për t'i dhënë kurajo fëmiut:

- Lavdëroje për ndarjen e ideve;
- Tregoni se belbëzimi nuk ju pengon;
- I jepni mundësi për të folur, si thirrja për të dhënë ndonjë përgjigje ose pyetja për opinionin e tij; dhe
- Le ta kuptoj se është në rregull për të belbëzuar.

Ju mund të keni pyetje tjera të përgjithshme lidhur me belbëzimin, fëmiun që belbëzon në klasën tuaj, ose për çfarë t'i thoni prindit të fëmiut që belbëzon. Ne ju kurajojmë të kontaktoni me logopedin në shkollën tuaj. Nëse nuk keni logoped në shkollën tuaj, kontaktoni për më shumë informata në The Stuttering Foundation.

Çfarë ndodh në terapinë për belbëzim

Qëllimet e terapisë për belbëzim

Zakonisht janë dy qëllime në terapinë për belbëzim:

- **Të folurit më të lehtë, dhe**
- **Zhvillimi i qëndrimeve dhe ndjenjave të shëndosha lidhur me të folurit.**

Lehtësiami i të folurit arrihet duke i mësuar fëmiut mjetet e të folurit. Këto mjete i ndihmojnë fëmiut të prodhojë të folur në një mënyrë tjetër, siq është redukimi i sasisë së tensionit në sistemin e të folurit, fillimi i fjalisë me më shumë ajër, ose belbëzimi në një mënyrë më të lehtë.

Zhvillimi i qëndrimit dhe ndjenjave më të shëndosha lidhur me të folurit arrihet duke i ndihmuar fëmiut të mësojë si të reagojë në situata folëse me më pak aksiozitet, duke u bërë më i sigurt në mundësinë e tij për të përdorur mjetet e të folurit, dhe duke përdorur aftësitë për zgjidhje të problemit për situatat e vështira folëse.

Jo të gjithë fëmijët ka nevojë të ndryshojnë se si ndjehen lidhur me të folurit. Shumë prej tyre janë të sigurt dhe kanë dëshirë të flasin me të tjerët. Megjithatë, për disa, të folurit mund të prodhojë ndjenja të anksozitetit ose frikës, madje edhe të fajit dhe turpfit. Mposhtja e këtyre qëndrimeve dhe ndjenjave negative mund të jetë po aq e rëndësishme për fëmiun sa edhe të mësuarit për të folur më me lehtësi.

Të folurit më rrjedhshëm është vetëm një pjesë për t'u bërë një komunikues i mirë. Të mësuarit për të respektuar rradhën, për të mos ndërhyrë, dhe përdorimi i kontaktit me sy gjatë të folurit janë të gjitha aftësi të rëndësishme komunikative. Nganjëherë, sa më fort që tenton fëmiu të përdor mjetet e tij që të jetë i rrjedhshëm, aq më shumë do të belbëzojë. Përsëri, është me rëndësi të kuptoj fëmiu se nuk duhet të kenë turp për faktin që belbëzojnë; është krejtësisht në rregull për të belbëzuar.

DVD “Stuttering: For Kids By Kids” (“Belbëzimi: Për fëmijët nga fëmijët”) është një mënyrë e mrekullueshme për fëmijë të vegjël të mësojnë më shumë dhe të shohim fëmijët tjerë që belbëzojnë.

Për më shumë informata se çfarë ndodh në një terapi për të folur, dy DVD nga The Stuttering Foundation mund të jenë me interes për ju ose fëmiun që belbëzon në klasën tuaj. “Therapy in Action: The School-Age Child Who Stutters” (“Terapia në aksion: shkollari që belbëzon”) fokusohet në fëmijët e shkollës fillore, dhe “Stuttering: Straight Talk for Teens” (“Belbëzimi: të flasim sinqerisht me tinejxherët”) është për adoleshentë. Më shumë informata lidhur me këto DVD mund të gjinden në fund të këtij doracaku.

Pse fëmijët mund të mos i përdorin mjetet e të folurit gjatë tërë kohës

Për të gjithë ne, të mësuarit për të ndryshuar mënyrën se si flasim është shumë e vështirë. Mendoni lidhur me sa herë kemi tentuar që të ngadalësojmë ose të përdorim një stil më ndryshe të të folurit, dhe mandej shqyrtoni a keni qenë të aftë të bëni këtë në të gjitha situatat dhe me të gjithë dëgjuesit!

Pritja e përdorimit të vazhdueshëm të mjeteve të të folurit mund të jetë veqanërisht e vështirë për një fëmijë që belbëzon. Arsye të mundshme që të mos jetë në gjendje ose të mos ketë dëshirë për të përdorur këto mjete përfshijnë:

- Kur është i eksituar ose me nxitim;
- Kur ndjehet se është i lodhur ose i sëmurë;
- Kur has në vështirësi me kërkesat e gjuhës në situatat e të folurit, si detyrimi për të dhënë një përgjigje veqanërisht të gjatë ose komplekse; ose

- Kur është i pasigurt lidhur me mënyrën e përdorimit të mjeteve të tij të të folurit.

Mënyra se si flasim është diçka që njerëzit që nuk belbëzojnë i japin shumë pak vëmendje. Një shembull i saktë se sa vështirë është për të bërë këtë ndryshim mund të jetë praktikimi i të shkruarit të nënshkrimit tuaj me dorën tjetër. Ne shpesh e përdorim këtë aktivitet me fëmijët si pjesë e prezantimit para klasës lidhur me belbëzimin ose me prindërit e fëmijëve që belbëzojnë. Pas tentimit për të shkruar me dorën tjetër ne bëjmë pyetje:

- Sa shumë duhet të mendoni lidhur me të shkruarit me dorën tjetër?
- A po ndjeheni natyrshëm?
- A po duket nënshkrimi juaj ashtu si do të duhej të duket?

Reagimet zakonisht përfshijnë se nënshkrimi me dorën tjetër merr një pjesë të madhe të të menduarit, ndjehet jo i natyrshëm për shkak të ndryshimit të këndit të lapsit ose sasisë së shtypjes që bëhet në letër, dhe nënshkrimi nuk duket fare i ngjashëm me nënshkrimin e zakonshëm të personit.

Mandej ne bëjmë analogji me atë çfarë ndjehet gjatë ndryshimit të të folurit: që kërkon koncentrim, që ndjehet jo i natyrshëm, dhe që tingëllon i ndryshëm. Këto janë arsyt shtesë pse fëmijët hezitojnë të përdorin mjetet e tyre të të folurit.

Ndryshimet që mund të presim nga terapia e të folurit

Terapia e të folurit mund të jetë një proces afatgjatë. Fëmijët mund të tregojnë ndryshime edhe se si flasin edhe se si ndjehen lidhur me të folurit duke mësuar për të menaxhuar me sukses belbëzimin e tyre. Si rezultat i terapisë për të folur, ju mund të vëreni se fëmiju:

- bëhet më i rrjedhshëm;
- belbëzon me më pak tension;
- përdor kontaktin me sy;
- përgjigjet vullnetarisht në pyetje se sa të përgjigjet vetëm kur ta ftoni;
- kontribon me ide gjatë sesioneve të shkëmbimeve të ideve;
- flet më shumë me bashkëmoshatarë; ose
- ndryshon se si flet dhe kur flet në mënyra tjera.

Mësimdhënësit ndajnë informacionin me logopedin

Nëse keni ndonjë fëmijë që belbëzon në klasën tuaj, informatat e juaja lidhur me fëmion dhe aftësitë e tij komunikuese janë me vlerë për logopedin. Megjithatë, ashtu si ju, shumë logopedë janë të zënë dhe mund të mos kenë mundësi të caktojnë një takim me ju për të biseduar në mënyrë specifike për fëmion.

Megjithatë, informatat e juaja janë të rëndësishme. Shqyrtoni mundësinë e ndarjes së informatave me logopedin përmes një takimi, e-maili ose një letre të shkruar, në lidhje me:

1. Vërejtjet tuaja se si ky fëmijë mëson më mirë në klasën tuaj;
2. Performancën akademike të fëmijut, dhe a është e ndikuar ajo nga belbëzimi;
 - A e ngrit dorën vullnetarisht në klasë?
 - A është vullnetar për të lexuar me zë?
 - A merr pjesë në diskutime ose në raportet me gojë?
 - A merr pjesë në aktivitetet kooperative mësimore?
3. Raportet e tij sociale dhe a mendoni se ato janë të ndikuara nga belbëzimi;
 - A duket se ka shumë shokë?
 - A e ngacmojnë të tjerët lidhur me belbëzimin?
 - A i ndërhyjnë të tjerëve ose nuk i lejon fëmijët tjerë të flasin me rradhë?
 - A e trajtojnë fëmijët tjerë atë ndryshe për shkak të belbëzimit, ose e trajtojnë si "njëri i bandës"?
4. Çfarëdo pyetje që mund të keni lidhur me...
 - Belbëzimin e fëmijut dhe aftësitë tjera komunikuese;
 - Terapinë e të folurit të fëmijut;
 - Belbëzimin në përgjithësi.

Pyetësi për mësimdhënës është në librin "The School-Age Child Who Stutters: Working Effectively with Attitudes and Emotions" (Fëmijët shkollor që belbëzojnë: Puna në mënyrë efektive me qasjet dhe emocionet) nga The Stuttering Foundation.

Mësimdhënësit ndajnë informacionin me prindërit

Prindërit mund të kenë shumë pyetje për ju lidhur me fëmiun e tyre dhe si belbëzimi i ndikon atij në klasë. Për shembull, ata mund të dëshirojnë të dijnë se a po merr pjesë aktive fëmiu në klasë, a po e ngacmojnë bashkëmoshatarët, ose mund të kenë pyetje themelore lidhur me belbëzimin. Nëse fëmiu nuk është për momentin në terapinë për të folurit, prindërit e tij mund të dëshirojnë të dijnë si mund të gjejnë ndihmë lidhur me belbëzimin.

Kur të takoheni me prindërit e fëmiut, shqyrtoni mundësinë e diskutimit të informatave të njëjta që mund t'i gjeni në pjesën e kaluar lidhur me ndarjen e informacionit me logopedë. Flisni me prindërit në mënyrë të hapur dhe të sqartë lidhur me atë si e shihni ju se si po ndikon belbëzimi te fëmiu. Shumë herë, informatat e juaja mund të paraqesin një siguri që ata kanë nevojë të ndihen të qetë se belbëzimi i tij nuk është problem për të në klasë. Megjithatë, nëse ju jeni të brengosur, informatat dhe shembujt që mund të paraqisni mund t'ju ndihmojnë prindërve që të vendosin lidhur me dhënien e ndihmës së duhur fëmiut.

Nëse ju mendoni se prindërit kanë nevojë për informata shtesë lidhur me belbëzimin, inkurajoni ata që të kontaktojnë me ndonjë logoped në shkollën tuaj. Nëse nuk ka logoped në shkollën tuaj, ju mund të kopjoni informatat nga ky doracak ose të kontaktoni me The Stuttering Foundation në 800-992-9392 ose www.stutteringhelp.org (www.belbezimi.org në gjuhën shqipe).

The Stuttering Foundation dërgon një paketë falas të informacionit për prindër, dhe web faqja ka burime të shumta për ta. Fondacioni ka publikuar disa libra dhe DVD që janë dedikuar për prindër, ku përfshihen “Stuttering: For Kids By Kids (DVD)” (Belbëzimi: nga fëmijët për fëmijët); “If Your Child Stutters: A Guide for Parents (libër)” (Nëse fëmiu juaj belbëzon: udhëzime për prindër); “Stuttering and Your Child: Questions and Answers (libër)” (Belbëzimi dhe fëmiu juaj: pyetje dhe përgjigje); dhe “Stuttering and Your Child: Help for Parents (DVD)” (Belbëzimi dhe fëmiu juaj: ndihma për prindër) që janë të dobishme për fëmijë të të gjitha moshave.

Përveq kësaj, më shumë se 8,500 librari publike kanë kopje të librave, DVD-ve dhe incizimeve të The Stuttering Foundation që mund t'i huazoni. Për listën e këtyre librarive, mund të shikoni në web faqen e fondacionit www.stutteringhelp.org, dhe klikoni në “Check Your Library” (Gjeni librarinë tuaj) e mandej shtetin tuaj.



A e keni ditur...

- Mbi tre milion amerikanë belbëzojnë.
- Belbëzimi ndikon tri deri në katër herë më shumë meshkujt se femrat
- Përafërisht 5 përqind e të gjithë fëmijëve kalojnë nëpër një periudhë të belbëzimit që zgjat gjashtë muaj ose më tepër. Tri të katërtat e tyre do të shërohen në fëmijërinë e hershme, duke mbetur 1% që do të kenë problem afatgjatë.
- Shumë hulumtime interesante në fushën e gjenetikës, neurologjisë, zhvillimit të fëmijëve dhe dinamikës së familjes kanë dhënë një sinjal në shkaktarët e mundshëm të belbëzimit. Si rezultat, ne kemi bërë një përparim të madh në parandalimin e belbëzimit të fëmijët e vegjël.
- Studimet tregojnë se njerëzit që belbëzojnë janë aq inteligjentë dhe të përshtatur mirë sa edhe ata që nuk belbëzojnë.
- Njerëzit që belbëzojnë janë shpesh të vetëdijshëm për këtë dhe mund të zgjedhin profesionin që dëshirojnë.
- As një metodë nuk është vërtetuar se vlen për të gjithë, edhe përkundër shumë raporteve të shërimeve përmes trajtimeve të reja, ilaqeve dhe aparaturave.
- Belbëzimi bëhet një problem i tmerrshëm gjatë adoleshencës.
- Një logoped mund të ndihmojë jo vetëm fëmijët por edhe adoleshentët, të rinjtë madje edhe më të moshuarit mund të bëjnë përparim të rëndësishëm drejt rrjedhshmërisë.
- Kenyon Martin, James Earl Jones, John Stossel, Darren Sproles, Annie Glenn, Bill Walton, Mel Tillis, Nicholas Brendon, Alan Rabinowitz, Joe Biden, Carly Simon, Ken Venturi, Bob Love, John Updike, Lewis Carrol, Mbreti George VI, Winston Churchill, Marilyn Monroe dhe John Melendez – janë të gjithë njerëz të famshëm që kanë belbëzuar.



PJESA II

Për logopedët

DVD “Belbëzimi: të flasim sinqerisht me mësimsdhënësit” është zhvilluar për t’i dhënë mësimsdhënësve informata praktike lidhur me belbëzimin duke pasur parasysh dy audienca:

- Mësimsdhënësit që do ta shikojnë këtë dokument në mënyrë të pavarur, dhe
- Logopedët që do ta përdorin këtë për t’i informuar mësimsdhënësit lidhur me belbëzimin.

Ky dokument mund të përdoret edhe nga administratorët e shkollës, stafi ndihmës në shkollë, prindërit si dhe studentët. Mbani mend kur ta shpërndani këtë DVD me audienca tjera, se ky është adresuar drejtpërdrejt për mësimsdhënësit e klasës. Ju mund të fotokopjoni pjesë të këtij doracaku për ata që do ta shikojnë videon.

Ju do të gjeni sugjerime dhe udhëzime për përdorimin e DVD-së edhe për prezantim para një grupi të madh edhe për takim individual me mësimsdhënës. Implementoni vetëm ato sugjerime që i’u përshtaten më së miri qëllimeve tuaja.

Ne gjithashtu kemi përfshirë edhe një listë të pyetjeve diskutuese për përdorim edhe në grupe të mëdha edhe në takime individuale. Është përfshirë edhe arsytimi për secilën pyetje.


Mandej janë udhëzimet për të bërë prezantimin para klasës lidhur me belbëzimin. The Stuttering Foundation ka të gatshme një paketë për prezantim para klasës me broshura, informata, dhe poster që mund t’i përdorni ju dhe fëmiju. Ju do të gjeni një listë të burimeve lidhur me belbëzimin në fund të këtij doracaku.

Udhëzime për punë në grupe të mëdha


Kjo DVD 20-minutëshe është disenjuar për përdorim si pjesë e një prezantimi, që zgjat diku prej 30-45 minuta. Ne ju inkurajojmë që të modifikoni sugjerimet për përmbajtjen ashtu që t’i përshtaten më së miri nevojave tuaja.

I. Hyrje (5 minuta)

- A. Paraqitni interesin tuaj personal për fëmijët që belbëzojnë dhe qëllimet tuaja për prezantimin.
- B. Paraqitni një hyrje të përmbajtjes së DVD-së dhe zgjatjes së saj. Mund të jetë e dobishme të sugjeroni që mësimsdhënësit të shkruajnë ndonjë gjë që NUK e kanë ditur lidhur me belbëzimin derisa janë duke shikuar; kjo mund të paraqes një temë për diskutim pas përfundimit të DVD-së.
- C. Edhe pse mësimsdhënësit mund të mos kenë aktualisht ndonjë fëmijë që belbëzon në klasën e tyre, ata mund të takojnë dikë që belbëzon në publik. Në këtë rast, është e dobishme për t’i orientuar mësimsdhënësit për numrin e fëmijëve që belbëzojnë në shkollë, ose numrin e të rriturve që belbëzojnë në Shtetet e Bashkuara.




John Stossel, korrespondent i lajmeve dhe ish-drejtuës i magazinës së lajmeve 20/20, i cili ende lufton me belbëzimin, dhe është bërë njëri nga reporterët më të suksesshëm në gazetarinë televizive sot.



Nën-presidenti Joseph Biden ka filluar karrierën e tij të gjatë politike kur është zgjedhur për herë të parë në Senatin e SHBA-ve më 1973 kur ka qenë vetëm 30 vjeçar.



Byron Pitts, korrespondent për magazinën televizive "60 Minutes", është gazetari i shpërblyer me Emmy dhe autor i "Step Out on Nothing" (Dalja nga asgjëja).



Ylli i basketbollit Kenyon Martin ka qenë dy herë anëtar i ekipit të SHBA-ve dhe është zgjedhur më 2004 në ekipin e yjeve të SHBA-ve.




Bob Love, ylli legjendar i Chichago Bulls, tani udhëheq Punët e Brendshme në Ligën Kampionale.



Ylli i NBA-së Bill Walton është i njohur edhe si komentator i NBC Sports.



Winston Churchill që ka marrë vëmendjen e miliona dëgjuesve gjatë fjalimit të tij inspirues gjatë Luftës së Dytë Botërore.



Në rolin e "Xander" në serinë e njohur televizive "Buffy the Vampire Slayer" (Bufi, vrasësi i vampirëve), Nicholas Brendon ka fituar adhurues të gjitha moshave.



Kongresmeni Frank Wolf nga Virginia mendon se përballja me sfidën e belbëzimit e ka përgaditur atë për t'u përballur me sfidat tjera në jetë.



Hulumtuasi, tradicionalisti dhe zoologu Alan Rabinowitz ka punuar pa u lodhur për të mbrojtur speciet në zhdukje siq përshkruhet në librat e tij të rinjë "Beyond the Last Village" (Përtej fshatit të fundit) dhe "Life in the Valley of Death" (Jeta në luginën e vdekjes).



Këngëtarja Carly Simon, fituese e një Oskari dhe një Grammy, përveq që ka shumë hit-albume, gjithashtu është edhe autore e librave për fëmijë.



Ylli i NFL-së (futbollit amerikan) Darren Sproles është një vrapues mbrojtës në futboll dhe specialist për kthim të topit dhe luan për San Diego Chargers. Dy herë ka qenë i emëruar lojtar yll i vitit për Kansas City.




Aktori James Earl Jones, ylli i televizionit dhe Broadway-it, është i mirënjohur për zërin e tij si "Darth Vader" në "Star Wars" (Lufta e Yjeve) dhe librin e tij "Voices and Silences" (Zërat dhe Heshjtjet).



Ylli i kauntri muzikës dhe artisti Mel Tillis ka argëtuar audiencën në tërë shtetin dhe në botë.



Mbreti George VI ka qenë inspirues për shtetin e tij dhe për botën gjatë Luftës së Dytë Botërore kur i'u është adresuar popullit në transmetimin e drejtpërdrejt në radio.



Lojtari legjendar i golfit Ken Venturi, kampion i U.S. Open, ka qenë një komentator i suksesshëm për CBS Sports.



Marilyn Monroe ka robëruar audiencën filmike dhe kolegët përgjatë karrierës së saj legjendare.



John Melendez, personaliteti i radios dhe shkrimtari për TV, është një muzicant, aktor dhe komedian i talentuar.

Nëse belbëzoni, definitivisht jeni në shoqëri të mirë!

II. Shikoni DVD-në (20 minuta)

III. Diskutoni (10-20 minuta, varësisht prej numrit të pyetjeve dhe ndërveprimit të grupit)

- A. Pyesni për reagimin e përgjithshëm lidhur me DVD-në.
- B. Pyesni mësimdhënësit për të ndarë një ose dy informata që kanë qenë të reja për ta ose ndjenjave që i'u kanë shprehur fëmijët dhe i ka befasuar ata.
- C. Nëse keni kohë, zgjedhni disa pyetje prej listës në këtë doracak dhe lehtësoni diskutimin. Mbani parasysh se çdo pyetje që bëni, si dhe reaksionet e juaja lidhur me përgjigjet e audiencës, ka potencialin për t'i bërë ata "të shtangur". Aftësia e juaj është për të zgjedhur cilat pyetje duhet bërë dhe mandej lehtësimi i një ndërveprimit të hapur, të sinqertë dhe të respektueshëm do të përcaktoj suksesin e diskutimit.
- D. Në fund të këtij prezantimi, paraqitni përsëri qëllimin tuaj, përmbledhni atë çfarë është mësuar dhe falenderoni grupin për pjesëmarrje.

Udhëzime për të udhëhequr diskutimet në grupe të mëdha

Ju ndoshta keni nevojë për të përsëritur një pyetje ose përgjigjen e ndonjërit për tërë grupin ashtu që secili të jetë në gjendje për ta dëgjuar. Kjo është posaqërisht me rëndësi nëse grupi është i madh ose ju jeni në një dhomë me akustikë të dobët. Në mënyrë periodike përmbledhni atë çfarë është duke diskutuar grupi. Kjo i ndihmon secilit të jetë i fokusuar dhe t'i riorientoni ata për çfarë po diskutohet. Për shembull,

"Idea e znj. Turner lidhur me atë se si e ka menaxhuar raportin me gojë me nxënësit e saj vërtetë e ka stimuluar diskutimin. Unë besoj që pajtohemi që X, Y dhe Z janë faktorë të rëndësishëm për t'u konsideruar kur mirremi me këtë qështje."

Nëse keni punuar me një mësimdhënës në të kaluarën, i cili ka një fëmijë që belbëzon në klasën e tij, ju mund ta pyesni mësimdhënësin për të ndarë informacionin lidhur me përvojën e tij. Një mënyrë e mirë për të pyetur atë është që së pari të bëni një përshkrim pozitiv për të. Për shembull,

"Vitin e kaluar znj. Clark ka patur Timmy X në klasën e saj. Një strategji që e di që ka qenë e dobishme për Timmy-in ishte që para mësimit, znj. Clark i ka treguar fëmijut se në çfarë rradhe do ta thërras atë. Unë mendoj se kjo vërtetë i ka ndihmuar Timmy-it për të parashikuar se kur do të ftohet për t'u përgjigjur. Znj. Clark, çfarë tjetër mendoni se ka qenë e dobishme për Timmy-in?"

Pranoni të gjitha përgjigjet njësoj, madje edhe nëse nuk pajtoheni me to. Nëse nuk pajtoheni dhe mendoni se kjo pikë ka nevojë për më shumë përpunim, prisni pak dhe diskutoni disa tema tjera, mandej përmbledhni dhe pyesni për pikëpamje tjera. Për shembull,

“Deri më tani ne kemi diskutuar për raportet me gojë, ngacmimin, dhe inkurajimin e fëmijëve që belbëzojnë për të folur më shumë në klasë. Ne kemi pasur disa pikëpamje të ndryshme që janë shprehur në këto tema. Le të kthehemi mbrapa te raportet me gojë, një sugjerim ishte që gjithmonë të kërkohet që nxënësi të jap raportin para klasës si mënyrë për të tejkaluar frikën. A ka dikush tjerët ndonjë mendim ose përvojë lidhur me këtë dhe dëshiron ta ndaj me ne?”

Gjithashtu, përdorni fjalitë në vetën e parë kur përgjigjeni. Në këtë mënyrë, personi i cili ka ofruar një ide me të cilën nuk pajtoheni ka më pak gjasa që të ndihet i prekur për shkak se ju përmbajtjen e përgjigjes suaj e fokusoni në vete sesa në personin tjetër.

“Unë mendoj se është me rëndësi për ne të diskutojmë këtë pak më shumë për shkak se kam pasur qështjen e njëjtë me fëmijët tjerë dhe unë nuk jam gjithmonë i sigurtë si të trajtohet kjo. Unë pyes se si ju tjerët ndiheni lidhur me këtë. Vërtetë, të gjithë ju keni më shumë përvojë me menaxhimin e nxënësve të cilët duhet të japin raport me gojë, dhe unë e di se shumë fëmijë tjerë kanë frikë nga kjo përvojë. Si i keni trajtuar fëmijët tjerë që kanë qenë të frikësuar?”

Nëse dikush pyet për këshillë, përdorni një kundër-pyetje (p.sh. “Hm, kjo është një pyetje e mirë. Si mendoni ju se duhet të trajtohen ngacmimet?”) ose drejtoni pyetjen për grupin në përgjithësi. Kjo do të nxjerr më shumë informata për personin që e ka bërë pyetjen dhe do të ofroj më shumë mundësi për bashkëpunim për të zgjidhur problemin.

Inkurajoni idetë dhe zgjidhjen e problemit nga të gjithë të pranishmit në grup. Pyesni ata që të paraqesin përvojat e tyre me fëmijë që janë përballur me situata të ngjashme; ndërsa jo të gjithë fëmijët belbëzojnë, shumë fëmijë kanë frikë të bashkëpunojnë në klasë për arsye të ndryshme, ngacmohen, ose duket se janë “të ndryshëm” prej bashkëmoshatarëve. Mësimdhënësit janë mësuar të përballen me shumë nga këto situata në baza ditore dhe kanë një përvojë të shëndoshë prej të cilave mund të mësojnë.

Udhëzime për takim individual me mësime dhënë

Nëse mësime dhënë e ka referuar një nxënës te ju për shkak të shqetësimit lidhur me belbëzimin, një pyetësor i shkurtë mund të jetë i dobishëm për mbledhjen e informatave fillestare lidhur me fëmijun. Një pyetësor që përdoret shpesh mund të gjindet në këtë faqe. Mësime dhënë pyetet për t'u përgjigjur në dhjetë fjali të përcaktuara:

1. Disa gjëra që i kam vërejtur lidhur me komunikimin e këtij fëmijë janë...
2. Kur ky fëmijë përgjigjet në klasë, ai/ajo ...
3. Kur ky fëmijë flet me mua në tavolinën time, ai/ajo ...
4. Kur ky fëmijë fletë me zë, ai/ajo ...
5. Nëse/kur ky fëmijë ka vështirësi gjatë të folurit, unë reagoj duke ...
6. Nëse/kur ky fëmijë ka vështirësi gjatë të folurit, fëmijët tjerë reagojnë duke ...
7. Nëse/kur ky fëmijë ka vështirësi gjatë të folurit, kjo ndodh zakonisht kur ...
8. Njohuritë e mia lidhur me belbëzimin janë ...
9. Shqetësimet e mia që kam lidhur me suksesin e këtij fëmijë në klasë janë ...
10. Më e rëndësishmja, tani më duhet të di ...

Kurdo gjatë terapisë, një pjesë e rëndësishme e procesit është takimi personal me mësime dhënësin e fëmijut që belbëzon. Ju mund të vendosni për t'i dhënë mësime dhënësit DVD-në "Të flasim sinqerisht me mësime dhënësit" për ta parë ai para se të takoheni me të, ose ta shikoni së bashku në takim si një mjet për të dhënë informata lidhur me belbëzimin.

Pas kësaj, një diskutim mund t'i adresoj në mënyrë të suksesshme qështjet specifike që kanë të bëjnë me nevojat e veqanta të fëmijut. Diskutoni pikëpamjet dhe shqetësimet e mësime dhënësit dhe ndihmoni atij të kuptoj rolin e rëndësishëm që luajnë mësime dhënësit në procesin e terapisë.

1. Para se të takoheni me mësime dhënësin, sigurohuni të flisni me fëmijun lidhur me atë se çfarë mendon ai që mund t'i ndihmoj atij në klasë.
2. Le ta kuptoj mësime dhënësi se pikëpamjet e tij janë shumë të rëndësishme për trajtimin e fëmijut.
3. Bëni pyetje lidhur me performancën e fëmijut në klasë, si p.sh.:
 - Cilat situata në klasën tuaj kërkojnë pjesëmarrje të suksesshme me gojë?
 - Në cilat situata e keni vërejtur se ky fëmijë flet lirshëm (p.sh., e ngrit dorën, është i disponuar për të marrë pjesë në diskutime)?
 - Në cilat situata e keni vërejtur se ka të folur të rrjedhshëm? Kur belbëzon?
 - Kur ky fëmijë belbëzon, çfarë vëreni se ai është duke bërë? (p.sh., tensionon buzët, përsërit fjalët, e largon shikimin, etj.)
 - A ka folur fëmijë ndonjëherë me ju lidhur me belbëzimin?

4. Jepni mësimdhënësit informata specifike lidhur me të folurit e fëmiut.
 - Kur ka filluar belbëzimi i fëmiut;
 - Çfarë gjëra bën ai kur belbëzon;
 - Çfarë mendoni se ai mendon dhe ndjen lidhur me belbëzimin.
5. Kuptoni perspektivën dhe pikëpamjet e mësimdhënësit.
 - Çfarë përvoja ka ai me personat që belbëzojnë?
 - Çfarë gjëra ka bërë tanimë që duket se janë të dobishme?
6. Tregoni se çfarë jeni duke punuar ju në terapi.
 - a. Emrat e mjeteve
 - b. Si tingëllojnë dhe si duken ato
7. Mos e mbingarkoni mësimdhënësin me informata dhe sugjerime. Tentoni t'i jepni një ose dy ide praktike që ai mund të filloj t'i përdor menjëherë, bazuar në shqetësimet e tij më të mëdha.
8. Shqyrtoni përfshirjen e nxënësit në takim me ju dhe mësimdhënësin. Flisni për temat si p.sh. çfarë dëshiron fëmiu që mësimdhënësi të dij lidhur me belbëzimin e tij dhe modeloni për mësimdhënësin aftësi të ndryshme të pëvetësuara në terapi.

Pyetje të mundshme për diskutim

Pyetjet në vijim mund të përdoren për të stimuluar diskutimin qoftë në grupe të mëdha ose në takime individuale me mësimdhënës. Lista e pyetjeve nuk është e plotë ose në ndonjë renditje të caktuar.

Secila pyetje është e përcjellur nga një arsyetim pse duhet bërë ajo. Zgjidhni disa pyetje që janë në përputhje me temën që do ta diskutoni si pjesë e qëllimeve tua në takime grupore ose individuale.

Paraqitja e këtyre pyetjeve mund të jetë më e lehtë në grupe të mëdha për shkak se grupet e mëdha më shpesh do t'i diskutojnë përgjigjet e dhëna nga mësimdhënësit. Në takime individuale, mësimdhënësi mund të mendoj se jeni duke bërë pyetje për ta zënë "ngushtë" dhe mund të ndjehet i kërcënuar. Si rezultat, ju duhet të bazoheni në njohuritë e juaja lidhur me mësimdhënësin, fëmiun, situatën dhe intuitën tuaj varësisht nga rrethanat.

Pyetja 1: si ndjeheni kur e dëgjoni një fëmijë duke belbëzuar?

Arsyetimi: Ndjenjat tona lidhur me dëgjimin e belbëzimit do të ndikojnë se si ne reagojmë dhe veprojmë me fëmiun. Është e zakonshme për njerëzit, përfshirë edhe logopedët, të ndjehen jokomod kur e dëgjojnë dikë duke belbëzuar. Shumë herë dëgjuesit nuk e dinë se çfarë të thonë ose si të reagojnë. Duke i lejuar njerëzit të shprehin ndjenjat e tyre në një ambient të sigurt është e rëndësishme në ndihmën e dëgjuesve për t'u ndjerë "komod" për të folur me njerëzit që belbëzojnë.

Për udhëzimet se si mësimdhënësit mund të reagojnë ndaj fëmijëve që belbëzojnë, referohuni në *pjesën I: Për mësimdhënësit* në këtë doracak.

Pyetja 2: Si reagoni ju verbalisht/fizikisht kur e dëgjoni një fëmijë duke belbëzuar?

Arsyetimi: Reaksionet ndaj fëmijëve që belbëzojnë mund ta bëjnë një fëmijë më shumë ose më pak rahat. Siç është theksuar, është e zakonshme që të ndihet një nivel i bezdisë kur dëgjojmë dikë duke belbëzuar. Edhe pse ne dëshirojmë të reagojmë në mënyrë të përshtatshme ndaj fëmijut, niveli jonë i bezdisë në mënyrë të pavetëdijshme na bën për të reaguar në një mënyrë më pak të dobishme si p.sh. një tensionim fizik, largimi i shikimit ose tentimi për ta plotësuar fjalën ose fjalinë për fëmijun. Këto reagime mund të shkaktojnë që fëmiju të ndihet “i bllokuar”, i refuzuar, ose i injoruar. Jepni mësimdhënësit një mundësi për të diskutuar këto mënyra të ndryshme të reagimit ndaj belbëzimit. Këto do t'i ndihmojnë edhe atij edhe fëmijut të ndihen më rahat.

Pyetja 3: Çfarë roli si mësimdhënës mendoni se duhet ta luani me fëmijun që belbëzon?

Arsyetimi: Informatat që mund të japin mësimdhënësit në përgjigje të kësaj pyetje do të ndihmojnë për të qartësuar se si mësimdhënësit mund të mbështesin procesin e terapisë. Mbani mend se mësimdhënësit kanë një detyrë tepër të madhe duke punuar me një popullatë dhe fëmijë shumë të ndryshëm dhe kërkesa të stërmëdha janë ngarkuar mbi supe të tyre për të ndihmuar dhe mësuar fëmijët me nevoja të ndryshme. Kur përballen me një fëmijë që ka edhe një problem shtesë, siq është belbëzimi, disa mësimdhënës mund të ndihen të dërmuar.

Duke diskutuar një pyetje si kjo, ju mund të zbuloni se çfarë mund të mendoj dhe të ndjej mësimdhënësi dhe mandej ndihmoni që të kuptoj se fëmiju që belbëzon nuk ka nevojë të trajtohet në mënyrë radikalisht të ndryshme. Përdorni videon për të kuptuar ai më mirë belbëzimin, mandej ofroni disa mënyra të zakonshme të ndërveprimit që ai ndoshta i përdor tanimë edhe me nxënësit tjerë.

Pyetja 4: Çfarë roli mendoni se duhet të kenë prindërit e fëmijut që belbëzon?

Arsyetimi: Përgjigja në këtë pyetje do të ndihmojë të qartësohet se çfarë janë pritjet e mësimdhënësit për prindërit. Mësimdhënësit mund të kenë ide të paramenduara në lidhje me rolin e prindërve, jo vetëm për origjinën e belbëzimit por gjithashtu edhe në atë se si duhet trajtuar. Ne dëshirojmë të ndihmojmë të ndërtohet një raport i shëndetshëm mes mësimdhënësit dhe prindit. Duke i lejuar mësimdhënësit mundësinë për të shprehur me zë idetë e paramenduara për rolin e prindërve në një atmosferë të sigurtë jo-gjyquese, i'u ndihmon juve që të keni intuitë se si të vazhdoni me mësimdhënësin dhe me prindërit. Cilat qëndrime janë të dobishme dhe që duhet të përforcohen? Cilat bindje duhet të modifikohen në mënyrë të sigurtë dhe jo-kërcënuese?

Pyetja 5: Cili është roli i logopedit në punën me fëmijun që belbëzon?

Arsyetimi: Kur ta bëni këtë pyetje, i'u jep juve mundësinë për të dëgjuar saktë se çfarë mund të pres mësimdhënësi nga ju, dhe i'u jep juve mundësinë për t'u përgjigjur në mënyrë mbështetëse dhe jo-kërcënuese edhe nëse perceptimi i rolit tuaj nuk është i njëjtë me atë të mësimdhënësit.

Kjo mund të sjell te një diskutim i hapur dhe konstruktiv lidhur me rolet e ndryshme që duhet të kenë edhe mësimdhënësi edhe logopedi. Kjo gjithashtu paraqet një mundësi për logopedin për t'i dhënë mësimdhënësit informata më specifike lidhur me terapinë e belbëzimit. Të dy konceptet janë të rëndësishme për zhvillimin dhe implementimin e Planit Individual Edukativ.

Pyetja 6: Cila është përvoja juaj me individë që belbëzojnë?

Arsyetimi: Është kritike për të kuptuar njohuritë e mësimdhënësit lidhur me përvojën me belbëzimin. Përgjigjet e tyre do të mundësojnë për të përcaktuar se a duhet të paraqisni për ta një fotografi më komplete të belbëzimit dhe një llojlojshmëri të gjërë të sjelljeve, qëndrimeve dhe ndjenjave të fëmijët që belbëzojnë.

Pyetjet 7 & 8: Çfarë keni bërë me fëmijët që belbëzojnë dhe që mendoni se janë të dobishme? A keni ndonjë përvojë që NUK ka qenë e dobishme?

Arsyetimi: Kjo ju mundëson juve të aprovoni atë se çfarë ka bërë tanimë mësimdhënësi dhe të bëni sugjerime për strategji edhe më të dobishme nëse është e nevojshme. Ne dëshirojmë që mësimdhënësit të ndajnë me neve ndërveprimet e mëhershme me fëmijët që belbëzojnë. Ju mund të diskutoni shembuj të ndryshëm që paraqesin mësimdhënësit, të vendosni se a janë ato vërtetë të dobishme, dhe strategji tjera për zgjidhje të problemit. Pyetje tjera që mund të dëshironi të bëni përfshijnë: Strategjitë që i keni përdorur a kanë qenë të dobishme për të gjithë fëmijët që belbëzojnë? Nëse jo, si mund të modifikohet strategjia për të ndikuar më mirë për fëmijun e caktuar?

Pyetja 9: Sa ka ndikuar kjo video për të kuptuar më mirë belbëzimin dhe fëmijët që belbëzojnë?

Arsyetimi: Është me rëndësi për të përcaktuar se a duhet të paraqisni më shumë informata lidhur me belbëzimin; prandaj, kjo është një pyetje e mirë për mbyllje. Në këtë pikë, mësimdhënësit kanë folur lidhur me qështjen, dhe kanë mësuar strategjitë që mund t'i ndihmojnë atyre që të ndihen më rehat ose të rrisin suksesin e ndërveprimit të tyre me fëmijët që belbëzojnë. Ju gjithashtu mund të fitoni një ndjenjë se a ka nevojë të paraqiten menjëherë informata tjera shtesë për ndihmuar diskutimin në grup ose diskutimin individual me mësimdhënësin në një ditë tjetër.

Udhëzime për prezentim para klasës për fëmijët që belbëzojnë:

(adaptuar me leje nga Murphy, 2002)

Diskutimi i nxënësit dhe logopedit lidhur me belbëzimin me shokët e klasës është një mjet i fuqishëm me shumë pasoja pozitive. Kur shokët e klasës janë të informuar lidhur me natyrën e belbëzimit, ngacmimi në klasë pothuajse gjithmonë redukohet ose eliminohet. Shokët e klasës gjithashtu bëhen mbrojtës të fëmiut që belbëzon dhe do t'i dalin në mbrojtje edhe në oborr kur fëmijët tjerë ta ngacmojnë atë.

Prezentimi para klasës është një mënyrë për të normalizuar ose “për të bërë jo të tmerrshëm” belbëzimin. Kur bëhet në mënyrën e duhur, belbëzimi është një temë më pak “e ngarkuar”, një qështje që mund të diskutohet hapur. Kjo hap mundësinë për logopedin që të shkoj drejt në klasë dhe të punoj hapur me fëmiun gjatë transferimit dhe mirëmbajtjes së aftësive që i ka mësuar në dhomën e logopedit. Nëse është e përshtatshme, mësimsdhënësi mund të sinjalizoj më lehtë fëmiun për të përdorur mjetet e tij të menaxhimit të belbëzimit.

Më e rëndësishmja, fëmiu fiton një përvojë të fuqishme gjatë të cilës ka një rast për t'u hapur vetë lidhur me belbëzimin në një ambient mbështetës dhe pranues. Ai mandej mund të praktikoj strategjitë e terapisë në klasë pa u brengosur lidhur me keqkuptimin ose talljet nga të tjerët. Kështu, vendoset themeli për të përdorur vetë-hapjen si një mjet menaxhues i belbëzimit. Fëmiu mësohet që të folurit hapur lidhur me belbëzimin i ndihmon vetë atij dhe bashkëmoshatarëve të tij.

Procedurat për të bërë një prezentim para klasës

Prezentimi para klasës për t'i ndihmuar fëmiut të diskutoj belbëzimin e tij me shokët e klasës duhet të bëhet vetëm nëse pranon fëmiu. Jo të gjithë fëmijët që belbëzojnë janë të gatshëm ose kanë dëshirë të bëjnë një prezentim para klasës për bashkëmoshatarët e tyre. Vendimi për të bërë prezentimin duhet të shikohet si një qëllim i terapisë lidhur me mënyrën se si fëmiu e mendon dhe e ndjen problemin, dhe gadishmëria e fëmiut për këtë aktivitet duhet të monitorohet me kujdes.

Për disa fëmijë, ky vendim është një detyrë e lehtë. Ata dëshirojnë që shokët e klasës të dijnë lidhur me belbëzimin. Për të tjerët që kanë qenë të ngacmuar lidhur me belbëzimin ose që kanë përjetuar emocione të forta negative, së pari duhet të punohet në zvoglimin e ndjeshmërisë së tyre. Strategjitë për të redukuar ose eliminuar anksozitetin, turpin dhe fajin duhet të praktikohen edhe brenda edhe jashtë dhomës së terapisë. (Vërejtje e botuesit: Për sugjerime të terapisë shikoni SFA DVD #9504, *“Dealing Effectively with Shame and Guilt”* (Përballja në mënyrë efektive me turpin dhe fajin), ose libri #0005, *“The School-age Child Who Stutters: Working Effectively with Attitudes & Emotions – A Workbook”* (Nxënësit që belbëzojnë: Të punuarit në mënyrë efektive me qëndrimet dhe emocionet – libër i punës).

Para se të bëni prezentimin para klasës, shpjegoni prindërve dhe mësimitdhënësve arsyetimin e kësaj përvoje. Madje edhe nëse fëmiju nuk është ngacmuar lidhur me belbëzimin nga shokët e klasës, ai do të përfitoj aftësi të rëndësishme.

Gjatë takimit me mësimitdhënësin, duhet të diskutohet për atmosferën e përgjithshme në klasë për të përcaktuar se a pret mësimitdhënësi ndonjë pengesë nga ndonjë fëmijë tjetër në klasë.

Fëmiju që belbëzon duhet të përfshihet në aktivitetet e planifikimit.

A dëshiron që ai ta informoj klasën lidhur me ndonjë qështje specifike? Sa në të vërtetë dëshiron të flas ai në krahasim me logopedin? Nëse ai është ende në pikën ku aftësitë e menaxhimit të të folurit nuk janë të qëndrueshme, logopedi mund të dëshiroj që të kufizoj pjesëmarrjen e fëmijut vetëm në pjesët folëse të shkurta, të ushtruara mirë ose të përdor strategjitë që dihet se prodhojnë shumë rrjedhshmëri, siq është të lexuarit në kor.

Qështjet që do të diskutohen varen sipas nevojave të fëmijut dhe moshës së tij. Fëmijët e kopshtit, të klasës së parë dhe të dytë mund të kuptojnë konceptin e të folurit “me gunga” ose “qalaman” dhe se është ndjenjë e keqe për të ngacmuar. Ata mund të kuptojnë se mësuesi i të folurit do ta mësoj fëmijun që belbëzon si të ketë një të folur më të “lëmuar”, por që nganjëherë të folurit “me gunga” mund të ndodh ende.

Fëmijët e klasës së tretë dhe të katërt mund të kuptojnë sqarime më komplekse lidhur me belbëzimin, si prodhohet të folurit, teknikat e terapisë së të folurit si dhe suksesin e paqëndrueshëm dhe kategorizimin e ngacmimeve.

Këtu është një shembull i paraqitur për prezentimin para klasës që mund të jetë i përshtatshëm për fëmijët e klasës së tretë dhe të katërt. Ju mund të dëshironi që ta përshtatni atë me stilin e juaj, nevojat e fëmijut të caktuar, dhe nivelin zhvillues të klasës.

Paraqitja e prezentimit para klasës

1. Hyrje

- Prezentoni veten si mësuesi i të folurit dhe shkurtimisht shpjegoni punën tuaj.

2. Pjesëmarrja e klasës

- Për të normalizuar konceptin e të pranuarit të terapisë së të folurit në klasë, pyesni fëmijët se sa prej jush kanë qenë në terapi për të folur më herët dhe si kanë punuar në terapi.
- Ndoshta ndonjë do të tregoj se fëmiju që belbëzon është duke ndjekur një terapi të tillë. Pranoni këtë si të vërtetë dhe së shpejti do të diskutohi për atë.

3. Flisni për problemet e tjera të të folurit dhe arsyetoni ardhjen tuaj në klasë

- Shkurtimisht tregoni se ka shumë lloje të vështirësive në të folur, p.sh. si artikulohej tingujt, zëri i ngjirur, etj., por sot ju dhe fëmiju do të fokusoheni në problemin që quhet belbëzim.
- Le ta kuptoj klasa se ju dhe fëmiju dëshironi t'i mësoni atyre disa gjëra interesante lidhur me belbëzimin dhe t'i edukoni ata, për shkak se ne të gjithë e dijme se sa e rëndësishme është edukimi i njerëzve.

4. Definoni belbëzimin dhe shkaktarët e tij

- Jepni një definicion të shkurtër që është i përshtatshëm me moshën e klasës.
- Kur të flisni me këtë nivel të moshës, ne dëshirojmë t'i pyesim fëmijët nëse ata e dinë se çka është belbëzimi dhe përmbledhni diskutimin, p.sh. "Belbëzimi është një problem i të folurit ku disa sisteme të të folurit të njerëzve nuk punojnë mirë gjatë tërë kohës. Kjo nuk është aq e pakoordinuar ashtu siq duket. Tingujt pengohen ose bllokohen. Ne nuk jemi të sigurt se çka e shkakton atë, por ne mendojmë se ndoshta disa njerëz janë të lindur kështu."

5. Njerëz të famshëm që belbëzojnë

- Ne dëshirojmë të pyesim klasën nëse ata dinë se shumë njerëz të famshëm dhe të suksesshëm kanë belbëzuar, dhe mandej shkurt tregojuni atyre lidhur me disa prej këtyre njerëzve të paraqitur në mes të këtij doracak (faqet 16-17).
- Si një ndihmë vizuale, ju mund të përdorni broshurën që vjen në këtë paketë për të treguar njerëzit e famshëm që belbëzojnë.

6. Nuk është faji i askujt

- Është shumë me rëndësi për të theksuar se askush nuk është përgjegjës për belbëzimin. Njerëzit nuk belbëzojnë për shkak se janë memec ose të sëmurë. Ajo nuk shkaktohet nga prindërit, dhe nuk është sëmundje që mund të infektoheni prej saj.

7. Mënyra të ndryshme për të belbëzuar

- Shumica e fëmijëve, pa marrë parasysh nivelin e tyre të menaxhimit të aftësive folëse, mund të përfshihen verbalisht në klasë gjatë prezentimit të kësaj pjese.
- Së bashku me fëmijun, demonstroi forma të ndryshme të sjelljeve të belbëzimit (p.sh. përsëritjet, bllokimet).
- Pyesni për vullnetarë për të imituar mostra të ndryshme. Nëse bëhen në mënyrë shoqërore, mund të jetë argëtuese për fëmijun që belbëzon, që të vlerësoj me nota tentimet e belbëzimit të shokëve të klasës (p.sh. notoni ata me 5, 4, 3, 2 ose 1).
- Tregoni se ky lloj i imitimit është vetëm për qëllim të të mësuarit dhe nuk duhet të bëhet herave tjera.
- Diskutimi në klasë mandej duhet të vazhdoj, ku fëmijët do të pyeten se si do të ndiheshin dhe do të vepronin nëse ata do të duhej të flisnin kështu gjatë tërë kohës.

8. Mjetet që mundësojnë të folur më të lehtë

- Duke përdorur nivel gjuhësor të përshtatshëm me fëmijët, së bashku mund të demonstroi teknikat e menaxhimit të të folurit të cilat është duke i mësuar fëmiju që belbëzon, p.sh. tërheqja, të folurit e zgjatur, etj.
- Mund të jetë e dobishme të pyesni disa nga fëmijët tjerë në klasë nëse ata mund të bëjnë disa nga teknikat e përmirësimit të rrjedhshmërisë, siq është të folurit e zgjatur. Këtu klasa mund të filloj të vlerësoj nivelin e vështirësisë gjatë përdorimit të teknikave të tilla menaxhuese.

9. Ne nuk mund të kemi sukses 100% - ndryshimi është i vështirë!

- Është me rëndësi që edhe mësimmëdhënësi edhe klasa të dallojnë se menaxhimi i të folurit gjatë bisedave është i vështirë dhe se fëmiju do të vazhdoj të ketë momente të belbëzimit të madh. Ndryshimi do të vij, por kërkohet kohë dhe praktikë.
- Mund të diskutohen ndikimet që e bëjnë të vështirë ndryshimin. Këto mund të ndryshojnë varësisht nga secili fëmijë por zakonisht ato përfshijnë: lodhjen, konkurrencën gjatë të folurit (p.sh. shumë fëmijë tentojnë të flasin njëkohësisht), dhe frika nga ngacmimi dhe tallja.

10. Pse njerëzit argëtohen në kurriz të tjerëve dhe si ndikon ajo në ne

- Pyesni klasën të ndajnë me ne informatën se për çfarë janë ngacmuar ndonjëherë. Shumica e fëmijëve të shkollave fillore janë të gatshëm të zbulojnë këtë informatë dhe duke bërë kështu krijohet një lidhje më e fortë mes fëmijëve.
- Ne gjithmonë e theksojmë se kushdo që është i gatshëm të ndaj me ne informatën se për çfarë është ngacmuar, është shumë trim.
- Është gjithashtu e dobishme të pyesim fëmijët se si i bën ata të ndihen dhe të veprojnë kur janë të ngacmuar.
- Mandej mund të bëhet paralele me ngacmimin e dikujt lidhur me belbëzimin.
- Ndhmoni fëmijëve për zgjidhje të problemit në mënyra të ndryshme të reagimit nëse ata dëgjojnë se ndonjë nga shokët e klasës ngacmohet ose tallet.

11. Si do të dëshironte fëmiju që të reagonin shokët e klasës në belbëzimin e tij

- Ju dhe fëmiju mund të bisedoni me shokët e klasës lidhur me mënyrën e reagimit në belbëzim në një mënyrë të dobishme.
- Ne kemi gjetur se shumë fëmijë të shkollave fillore në të vërtetë mirëpresin shokët e klasës për t'ia plotësuar fjalët në të cilat ata belbëzojnë, derisa të tjerët dëshirojnë që dëgjuarit të jenë të durueshëm dhe të presin derisa ata të jenë në gjendje të thonë fjalën.

Diskutimi në mënyrën e duhur dhe vetë-zbulimi i belbëzimit e nxjerr këtë çrregullim jashtë dollapit. Ajo mund të zbuloj "sekretin që e din secili por askush nuk flet për të", duke e redukuar turpin, frikën dhe misterin. Vetë-zbulimi dhe format tjera të zvoglimin të ndjeshmërisë mund të bëhen në mënyrë të përsëritur por në një kontekst të sigurt, dhe të përshtatshëm nga ana sociale siq është prezentimit para klasës, loja, ose videot e përshtatura për fëmijë lidhur me belbëzimin.

Burimet

Ne kemi përpiluar një listë të burimeve lidhur me terapinë e belbëzimit, ngacmimit, dhe ndërtimit të vetë-besimit për fëmijët. Lista përfshin burime për fëmijë 🌱, prindër 🧡, mësimdhënës 📚, dhe logopedë 🗣️. Secili burim është listuar me kodin për audiencën e sugjeruar, megjithatë këto burime janë të dobishme për secilin. Ju gjithashtu mund të telefononi The Stuttering Foundation në 800-992-9392 për një listë të grupeve mbështetëse.

Bullies Are a Pain in the Brain (Ngacmimet janë dhimbje për trurin), nga T. Romain dhe E. Verdick. Ky libër kombinon humorin me sugjerimet praktike për t'i ndihmuar fëmijëve të moshës 8-13 vjeqare të bëhen "të pandikuar nga ngacmimet", të gjejnë ndihmë në situata të rrezikshme, dhe të ndërpresin ngacmimet për të tjerët. Informatat për ngacmimet gjithashtu përfshijnë edhe ndihmën për t'i ndihmuar që së bashku me të tjerët të ndihen mirë për veten pa pasur nevojë të bëjmë të tjerët të ndihen keq. Porositni nga Free Spirit Publishing. 🌱

The Bully Free Classroom: Over 100 Tips and Strategies for Teachers K-8 (Klasa pa ngacmime: mbi 100 këshilla dhe strategji për mësimdhënës K-8), nga A. L. Beane. Më shumë se 100 sugjerime praktike për parandalimin dhe intervenimin ndaj ngacmimeve dhe talljeve gjinden në këtë libër që mund të përdoren menjëherë. Përfshin 45 faqe të fletëpalosjeve për vetësuesë që mund të kopjohen. Porositni nga Free Spirit Publishing. 📚

Classroom Presentation Packet (Paketa për prezantim para klasës). Kjo paketë me materiale përmban mjete interesante për përdorim kur fëmijët bëjnë prezantime para klasës së tyre lidhur me belbëzimin. Në paketë përfshihen: 30 kopje të 18 njerëzve të famshëm që belbëzojnë; një poster i 18 njerëzve të famshëm që belbëzojnë; dhe një poster nga Nick Brendon për Javën Nacionale të Vetëdijësimit për Belbëzimin. Të gjitha materialet janë me ngjyra. Porositni drejtpërdrejt nga The Stuttering Foundation, #0130. 📚 🌱

Decoding IDEA Eligibility (Dekodimi i përshtatshmërisë të IDEA – Individual with Disabilities Education Act) nga L. Scott. Kjo DVD që zgjat 1 orë e 50 minuta diskuton për strategjitë konkrete për vendosjen e përshtatshmërisë për nxënës të shkollave që belbëzojnë sipas udhëzimit nga IDEA. Metoda specifike janë përshkruar për dokumentimin e informatave zhvillimore, akademike dhe funksionale për fëmijët që belbëzojnë. Përfshin PDF të prezimit me PowerPoint. Porositni drejtpërdrejt nga The Stuttering Foundation, #6100. 🗣️

Do you stutter: A Guide for Teens (A belbëzoni: Udhëzues për tinejxherë), botimi i katërt. Disa probleme janë unike për tinejxherët që belbëzojnë. Ky libër me 80 faqe është i shkruar për tinejxherë për të ofruar këshilla në zgjidhjen e disa prej këtyre problemeve. Të gjithë kapitujt janë shkruar nga specialistë në fushën e belbëzimit. Disa nga këta specialistë belbëzojnë edhe vetë. Porositni drejtpërdrejt nga The Stuttering Foundation, #0021. 🌱

Famous People Who Stutter Poster (Posteri i njerëzve të famshëm që belbëzojnë). Tetëmbëdhjetë fytyra të famshme që belbëzojnë me ngjyra. Nicholas Brendon, James Earl Jones, Annie Glenn, John Stossel, Marilyn Monroe, Bob Love, Mel Tillis, Bill Walton, Carly Simon, Mbreti George VI, Frank Wolf, Ken Venturi, John Updike, Joe Biden, Winston Churchill, Kenyon Martin, John Melendez dhe Darren Sproles. 24" x 18". Ideale për të gjitha rastet për rritjen e vetëdijes lidhur me belbëzimin. Porositni drejtpërdrejt nga The Stuttering Foundation, #0054. 📚 🌱

Fighting Invisible Tigers: A Stress Management Guide for Teens (Lufta me tigra e padukshëm: udhëzues për menaxhimin e stresit për tinejxherë), botim i përmirësuar, nga E. Hipp dhe M. Fleishman. Ky libër është shkruar posaçërisht për tinejxherë të klasave 6 – 12, është një burim i mrekullueshëm për menaxhim të stresit dhe aftësitë e menaxhimit të jetës. Përmban materiale për mënyrën se si të jemi të sigurt në vete, të ndërtojim raporte, të ndërmarrim rreziqe, të marrim vendime, të përballemi me frikën, të përdorim të folurit pozitiv me veten, dhe më shumë. "Vetë-kujdesi për kafshimin e tigrit" ofron një "ndihmë të parë" të menjëhershme për tinejxherët që kanë nevojë për lehtësim të shpejtë të stresit. Mund të porositet gjithashtu "Leader's Guide" (Udhëzuesi për lider) që përmban një kurikulum hap pas hapi për 12 sesione dhe fletëpalosje për vetësuesë. Porositni nga Free Spirit Publishing. 🌱

Good Friends are Hard to Find: Help Your Child Find, Make, and Keep Friends (Shokët e mirë gjinden vështirë: ndihmoni fëmijë tuaj të gjej, të bëj dhe të mbaj shokët), nga F. Frankel dhe B. Wetmore. Një udhëzues hap pas hapi për prindër të fëmijëve të moshës 5-12 vjeq, që i tregon atyre si të ndihmojnë fëmijët e tyre të bëjnë shokë dhe të sillen me fëmijët tjerë. Përfshin sugjerime për sjelljen ndaj ngacmimit, talljes dhe poshtërsisë, pa marrë parasysh se a është fëmiju që po ngacmohet apo po ngacmon. www.amazon.com. 🗣️

How to Talk So Kids Will Listen and Listen So Kids Will Talk (Si të flasim që të dëgjojnë fëmijët, dhe si të dëgjojmë që të flasim fëmijët), nga A. Faber dhe E. Mazlish. Ky libër përshkruan një qasje hap pas hapi për përmirësimin e komunikimit në shtëpi. Faqet "për kujtesë", vizatimet e dobishme, dhe shembujt e shkëlqyer do të përmirësojnë aftësitë e prindërve për të folur dhe zgjidhur problemet me fëmijët. Sugjerimet janë gjithashtu të përshtatshme edhe për mësimdhënësit. Mjetet e paraqitura janë të përshtatshme për fëmijët e të gjitha moshave. Mund të gjindet në pothuajse të gjitha libraritë ose të porositet nga www.amazon.com. 🗣️

If Your Child Stutters: A Guide for Parents (Nëse fëmiju juaj belbëzon: udhëzues për prindër), edicioni i shtatë. Është shkruar për ata që janë të brengosur lidhur me të folurit e fëmijëve të vegjël, dhe ky libër ndihmon të bëhet dallimi mes jorregjueshmërisë normale dhe belbëzimit, dhe ofron sugjerime praktike për prindër që mund të përdoren menjëherë me fëmijët e tyre. Për këtë libër kanë kontribuar shumë ekspertë në fushën e belbëzimit. Porositni drejtpërdrejt nga The Stuttering Foundation, #0011. Ky libër është përkthyer edhe në gjuhën shqipe dhe mund ta shkarkoni falas nga www.belbezimi.org.

If You Think Your Child is Stuttering, New Tips for Parents (Nëse mendoni se fëmiju juaj belbëzon, këshilla të reja për prindër). Kjo broshurë popullore përshkruan dallimin mes jorregjueshmërisë normale dhe belbëzimit dhe ofron 9 këshilla që prindërit mund t'i përdorin menjëherë për t'u ndihmuar fëmijëve të tyre. Porositni drejtpërdrejt nga The Stuttering Foundation, #0041.

I'm Like You, You're Like Me: A Child's Book About Understanding and Celebrating Each Other (Unë jam si ti, ti je si unë: libër për fëmijë lidhur me të kuptuarit dhe lavdërimin e njëri-tjetrit) nga C. Gainer. Fjalët e thjeshta dhe ilustrimet e bukura i ndihmojnë fëmijëve të moshës 3-8 vjeq të zbulojnë dhe lavdërojnë me nivelin e tyre dallimet individuale: flokët, familjet, format e trupit, etj. Temat e shqyrtuara me fjalë të thjeshta përfshijnë të folurit, të dëgjuarit, ndjenjat dhe bashkëpunimin. Gjithashtu mund të porositet "Leader's Guide" (Udhëzuesi për lider) që përfshin aktivitetet, pyetjet diskutuese, dhe fletëpalosje për prindër që mund të kopjohen. Porositni nga Free Spirit Publishing.

Implementing Cognitive Behavior Therapy with School-Age Children (Implementimi i Terapisë së Shprehive Njohëse me fëmijët shkollor) nga L. Scott. Kjo DVD që zgjat 1 orë e 40 minuta diskuton strategjitë dhe idetë praktike për implementimin e Terapisë së Shprehive Njohëse me fëmijët. Këtë duhet ta ketë secili logoped që punon me fëmijë të shkollës fillore. Porositni drejtpërdrejt nga The Stuttering Foundation, #6500.

The School-Age Child Who Stutters: Working Effectively with Attitudes and Emotions – A Workbook (Fëmijët shkollor që belbëzojnë: puna efektive me qëndrime dhe emocione – manual), nga K. Chmela dhe N. Reardon. Janë prezentuar strategji të shumta për t'u ndihmuar fëmijëve të kenë ndryshime pozitive në ndjenja dhe besim duke përdorur shembuj nga fëmijë real. Janë përfshirë metoda konkrete për dokumentimin e nivelit aktual të ndjenjave dhe besimit, si dhe ide të terapisë për të promovuar ndryshimin. Ka edhe faqe që mund të kopjohen përgjatë tërë librit. Porositni drejtpërdrejt nga The Stuttering Foundation, #0005.

Scoring Disfluencies (Vlerësimi i jorregjueshmëriave) nga D. Parris. Parris demonstroi një qasje pragmatike për të vlerësuar jorregjueshmëritë duke përdorur dy raste si shembuj për praktikë në këtë DVD që zgjat një orë. Janë përfshirë edhe formularë dhe slajde për llogaritje që mund të kopjohen. Porositni drejtpërdrejt nga The Stuttering Foundation, #6350.

Sometimes I Just Stutter (Nga njëherë unë thjesht belbëzoj), një libër për moshën 7 deri në 12 vjeq, nga E. de Geus. E shkruar për fëmijë që belbëzojnë, ky libër flet lidhur se çfarë ju bën juve të belbëzoni, pse nga njëherë ju belbëzoni e nga njëherë jo, pse disa njerëz nuk e kuptojnë pse ju belbëzoni, çfarë dijnë të tjerët lidhur me belbëzimin, që ka edhe shumë fëmijë tjerë që belbëzojnë gjithashtu, dhe çfarë të bëni nëse ju ngacmojnë të tjerët lidhur me belbëzimin. Porositni drejtpërdrejt nga The Stuttering Foundation, #0031.

Stick Up For Yourself! Every Kid's Guide to Personal Power and Positive Self-Esteem (Ngritni veten në këmbë! Udhëzues për çdo fëmijë për fuqi personale dhe vetë-besim pozitiv), e përmirësuar, nga G. Kaufman, L. Raphael, dhe P. Espeland. E shkruar për fëmijë të klasës 3-7, ky libër përmban fjalë të thjeshta me shembuj nga jeta reale për ndihmë fëmijëve për të formuar vetë-besimin, aftësitë për siguri në vete, përgjegjësitë dhe marrëdhëniet e shëndosha. Gjithashtu për këtë libër është edhe "Leader's Guide" (Udhëzuesi për mësimdhënës) me skicën për 10 sesione që përfshijnë edhe materiale që mund të kopjohen. Porositni nga Free Spirit Publishing.

Sticks and Stones: 7 Ways Your Child Can Deal With Teasing, Conflict, and Other Hard Times (Shkopinjë dhe gurë: 7 mënyra për fëmijun tuaj për t'u përballur me ngacmimin, konfliktin dhe kohët tjera të vështira), nga S. Cooper. Ky libër i ndihmon prindërvë të fëmijëve të moshës 4-12 vjeq për t'i mësuar fëmijët e tyre aftësitë verbale që i'u nevojiten për t'u mbrojtur nga fjalët që lëndojnë që i'a thonë të tjerët. Ka shembuj dhe skripte mostra që i ndihmojnë fëmijëve të mësojnë për të mbrojtur veten, ndalojnë talljet, kundërvihen presionit nga bashkëmoshatarët, përballen me përlëshjet, etj. www.Amazon.com.

Stress Can Really Get on Your Nerves! (Stresi mundet vërtet të ndikoj në nerva!), nga T. Romain dhe E. Verdick. Duke kombinuar fakte, pohime dhe humor, ky libër i shkruar për fëmijë të moshës 8-13 vjeq i'u ndihmon për të kuptuar dhe menaxhuar stresin e tyre. Ky libër ofron mënyra specifike për t'u përballur me stresin. Porositni nga Free Spirit Publishing.

Stuttering and Your Child: Help for Parents (Belbëzimi dhe fëmiju juaj: ndihmë për prindërit). Kjo DVD 30 minutëshe është për familje të fëmijëve parashkollor që belbëzojnë. Kjo fokusohet në ndihmën e familjes për të kuptuar belbëzimin dhe bën ndryshime për të promovuar më shumë të folurit e rrjedhshëm. Porositni drejtpërdrejt nga The Stuttering Foundation, #0073.

Stuttering and Your Child: Questions and Answers (Belbëzimi dhe fëmiju juaj: pyetje dhe përgjigje), edicioni i katërt. Ky libër paraqet mendimet më të reja të shtatë autoriteteve nga fusha e belbëzimit. Përgjigjet për pyetjet që më së shpeshti i bëjnë prindërit, i mundësojnë atyre për të punuar me fëmijën e tyre në mënyra që të kontribuojnë në zhvillimin e një rrjedhshmërie më të mirë. Ky libër është i domosdoshëm edhe për prindër edhe për mësimitdhënës. Porositni drejtpërdrejt nga The Stuttering Foundation, #0022. 📖 🍎

Stuttering: For Kids, By Kids (Belbëzimi: për fëmijët, nga fëmijët). Logopedët e specializuar në tretmanin e çrregullimeve të rrjedhshmërisë kanë shpenzuar më shumë se një vit për të zhvilluar skriptën për këtë DVD 12-minutësh. Rezultati është një DVD e gjallë, tërheqëse dhe shumë efikase që i'u jep fëmijëve një mënyrë pozitive për të menaxhuar me belbëzimin e tyre, ndihmojnë vetëbesimin dhe i'u ndihmon atyre për t'u ndjerë më mirë me veten. Një mënyrë e re dhe jo-kërcënuese për të diskutuar për belbëzimin. Porositni drejtpërdrejt nga The Stuttering Foundation, DVD #9172. Në një DVD janë përfshirë versioni në gjuhën angleze dhe spanjolle. 📖 🍎 😊

Stuttering: Straight Talk for Teens (Belbëzimi: të bisedojmë sinqerisht me tinejxherët). Secili tinejxher duhet të dijë se ai ose ajo nuk janë vetëm, dhe se ndihma reale është e mundur. Në këtë DVD 30-minutësh, tinejxherët ndajnë përvojën dhe flasin lidhur me atë si funksionon kjo. Logopedët demostrojnë dhe diskutojnë se çfarë është belbëzimi, brengat dhe ndjenjat e shoqëruara me belbëzimin, dhe mënyrat se si tinejxherët mund të ndihmojnë veten dhe ku mund të gjejnë ndihmë. Porositni drejtpërdrejt nga The Stuttering Foundation, #1076. 📖 🍎

Treating the School-Age Child Who Stutters: A Guide for Clinicians (Trajtimi i fëmijëve shkollor që belbëzojnë: një udhëzues për logoped), edicioni i dytë nga C. Dell. I shkruar nga ish-logopedi i shkollës publike, i cili ka qenë njëri nga të parët që është trajnuar si specialist për belbëzim, ky libër me 108 faqe ofron dialogje shembuj dhe mjete të shumta për të punuar në mënyrë efikase me fëmijë shkollor që belbëzojnë. E domosdoshme për çdo logoped të shkollave publike që punojnë me fëmijë të shkollave fillore. Porositni drejtpërdrejt nga The Stuttering Foundation, #0014. 📖 🍎

Therapy in Action: the School-Age Child Who Stutters (Terapia në aksion: fëmijët shkollor që belbëzojnë). Kjo DVD 40-minutësh paraqet informata lidhur me si duket dhe si tingëllon belbëzimi, adreson brengat e shoqëruara me belbëzim të fëmijët shkollor, dhe demonstroi segmente të terapisë në aksion nga specialistë të njohur me fëmijë shkollor. Porositni drejtpërdrejt nga The Stuttering Foundation, DVD #1079. 📖 🍎 😊

Trouble at Recess (Bezdi në pushim). Ky libër me 30 faqe është i shkruar dhe i ilustruar nga Jamie 8 vjeçar që përshkruan fatkeqësitë me të cilat përballen shumë fëmijë që belbëzojnë edhe në klasë edhe në lojë. E domosdoshme për të gjithë fëmijët që belbëzojnë dhe të tjerët, gjithashtu! Porositni drejtpërdrejt nga The Stuttering Foundation, #0034. 📖 🍎

We Can Get Along: A Child's Book of Choices (Ne mund t'ia dalim: një libër i zgjedhjeve për fëmijë), nga L. M. Payne dhe C. Rohling. Për fëmijë të moshës 3-8 vjeçare, ky libër mëson për zgjidhjen e konflikteve dhe aftësitë paqeruajtëse në atë mënyrë që mund ta kuptojnë fëmijët e vegjël. Mund të porositet gjithashtu edhe "Leader's Guide" (Udhëzuesi për lider) që përfshin aktivitete, pyetje diskutuese dhe fletëpalosje për prindër që mund të kopjohen. Porositni nga Free Spirit Publishing. 📖 🍎

Wendi's Magical Voice (Zëri magjik i Uendit) nga B. Kohls. Ky libër me 32 faqe, i shkruar dhe i ilustruar nga Kohls është një tregim imagjnativ dhe i shkruar mirë lidhur me një vajzë që belbëzon. Fëmijët do të identifikohen me frikën e saj në klasë dhe si ajo i tejkalon ato. Porositni drejtpërdrejt nga The Stuttering Foundation, # 0035. 📖 🍎

Mitet lidhur me belbëzimin

Miti: Njerëzit që belbëzojnë nuk janë të menqur.

Realiteti: Nuk ka asnjë relacion mes belbëzimit dhe inteligjencës.

Miti: Neuroza shkakton belbëzimin.

Realiteti: Neuroza nuk shkakton belbëzimin. Dhe as nuk mund të supozojmë se njerëzit që belbëzojnë janë të prirur të jenë nervoz, të druajtur, ansioz ose të turpshëm. Ata kanë personalitetin e tyre të plotë njësoj si ata që nuk belbëzojnë.

Miti: Belbëzimi mund të “ngjitet” përmes imitimeve ose duke e dëgjuar një person që belbëzon.


Realiteti: Belbëzimi nuk “ngjitet”. Askush nuk e di shkakun e vërtetë të belbëzimit, por hulumtimet e fundit tregojnë se historia familjare (gjenetika), zhvillimi neuromuskular, dhe ambienti i fëmijut, përfshirë dinamikën e familjes, të gjitha luajnë rol në paraqitjen e belbëzimit.

Miti: Ndhomon që t’i tregojmë personit që “të marr thellë frymë para se të flas,” ose “të mendoj së pari para se të flas.”

Realiteti: Kjo këshillë e bënë personin edhe më të vetëdijsëm, dhe e bën belbëzimin edhe më të vështirë. Reagime më të dobishme përfshijnë të dëgjuarit me durim dhe duke modeluar vetë një të folur të ngadalshëm dhe të qartë.

Miti: Stresi shkakton belbëzimin.

Realiteti: Siç është cekur më lartë, janë të përfshirë shumë faktorë. Stresi nuk është shkaktar, por sigurisht mund të keqësojë belbëzimin.



THE
STUTTERING
FOUNDATION®

A Nonprofit Organization

Since 1947—Helping Those Who Stutter

P.O. Box 11749 • Memphis, TN 38111-0749

info@stutteringhelp.org

800-992-9392

www.stutteringhelp.org www.tartamudez.org

www.belbezimi.org

ISBN 978-9951-698-01-6

ISBN 978-9951-698-01-6

